



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 47, datë 13.06.2018**

**PËR LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a Ujësjetllës Kanalizime Dibër për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Peshkopi (Dibër) me NUIS J66702738B është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 11, datë 21.05.2014 "Për licencimin sh.a Ujësjetllës Kanalizime Peshkopi", me vlefshmëri për kategoritë A deri më datë 12.11.2016 ndërsa për kategorinë C deri më 20.05.2018.
- Shoqëria me shkresë nr. 78 prot. datë 15.01.2018 ka aplikuar pranë ERU për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës. Me shkresë nr. 294 prot. datë 31.05.2018 janë bërë plotësimet përkatëse në dosjen e aplikimit pas mangësive që kishte.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Dibër plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:
  - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Janë bërë ndryshimet përkatëse në ekstraktin e QKB mbi emrin e subjektit;
  - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit sh.a Ujësjetllës Kanalizime Dibër me:  
Drejtues Ligjor Arif Shini  
Drejtuesit Teknik Dritan Nuzi
2. Operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Dibër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:  
  
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;  
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Dibër, si më poshtë:
  - a) Njësitë administrative: Peshkopi
  - b) Qendër Tomin
  - c) Kastriot
  - d) Luzni
  - e) Sllovë
  - f) Kala e Dodës
  - g) Fushë – Çidhën
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**